

V E N D I M

Nr.50, datë 28.1.1999

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MBI TË CILËN DO TË LLOGARITET TAKSA E SOLIDARITETIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Për efekt të pagimit të taksës së solidaritetit, të parashikuar në nenin 6, në shkronjën “r” (lidhja 10, pika 6) të ligjit nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, si pagë mujore do të llogaritet paga bazë, pa shtesat që kanë karakter të përhershëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

